



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 11, 12.2 shkronja d), 17 shkronja s) dhe 40.2 shkronja a) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, neneve 14, 15 paragrafi 3, nenet 19 paragrafi 1.19 dhe nenin 34 paragrafi 2.1 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18 të datës 29.06.2018, dhe në pajtim me Rregulloren e Punës së Kuvendit nr.01/146-11 të datës 29 prill 2010, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 30 korrik 2026, mori këtë:

V E N D I M

PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT STATUTAR PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E STATUTIT TË KOMUNËS SË PODUJEVËS

Neni 1

1. Me këtë vendim themelohet Komisioni Statutar për plotësimin dhe ndryshimin e Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, me përbërjen si në vijim:

Isak Shabani, Kryesues i Kuvendit, anëtar nga përbërja e Kuvendit të Komunës, (PDK)
Haki Rudari, anëtar nga përbërja e Kuvendit të Komunës, (LVV)
Adelina Stublla, anëtare nga përbërja e Kuvendit të Komunës, (LVV)
Besim Latifi, anëtar nga përbërja e Kuvendit të Komunës, (LDK)
Arnisa Sylejmani, anëtare nga përbërja e Kuvendit të Komunës, (LDK)
Demokrat Hodolli, anëtar nga përbërja e Kuvendit të Komunës, (GUXO)
Gentrit Arifi, anëtar nga përbërja e Kuvendit të Komunës, (Unioni i Blakçorve)
Baki Feta, anëtar nga përbërja e Kuvendit të Komunës, (AAK)
Lirie Hoti Rama, anëtare nga përbërja e Ekzekutivit të Komunës
Avni Fetahu, anëtar nga përbërja e Ekzekutivit të Komunës
Behram Latifi, anëtar nga përbërja e Ekzekutivit të Komunës

2. Zyra Ligjore e Komunës është pjesë përbërëse e Komisionit sa i përket ofrimit të mbështetjes dhe ndihmës profesionale dhe teknike në procesin e hartimit të draftit të aktit.

3. Kryesuesi/ja i/e Komisionit zgjedhet me shumicën e votave të anëtarëve të këtij komisioni dhe i njëjti organizon dhe kryeson punën e komisionit.

Neni 2

Punët dhe detyrat e Komisionit sipas nenit 1 të këtij vendimi, ndër të tjera, janë:

- Të harmonizon dispozitat e Statutit si dokument, me dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi, aty ku Komisioni e sheh të arsyeshme apo që paraqitet nevoja për plotësim ndryshim.
- Të shqyrton iniciativat-propozimet e Kryetarit të Komunës, për plotësimin dhe ndryshimin e Statutit.
- Të organizon dhe mbajë konsultime të brendshme, konsultime publik me qytetarë dhe grupe tjera të interesit, konform rregullativës ligjore në fuqi
- Të shqyrton dhe vendos lidhur me kërkesat, propozimet, rekomandimet dhe sugjerimet e paraqitura nga procesi i konsultimit publike.
- Të përgatitë raportin final nga konsultimet publike.
- Të përgatitë Draftin e aktit dhe të njëjtin pas shqyrtimit përfundimtar t'ia rekomandon Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.
- Sipas nevojave të paraqitura, Komisioni apo ndonjë anëtar/e i/e Komisionit mund të ketë konsultime paraprake rreth këtij procesi me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si organ mbikëqyrës i funksionimit të Komunave.
- Komisioni mund të vendos edhe për çështje tjera rreth këtij procesi, por gjithnjë brenda fushëveprimit dhe natyrës së këtij vendimi.

Neni 3

Komisioni themelohet në mandat të njëjtë me mandatin aktual të Kuvendit të Komunës, përveç nëse Kuvendi vendos ndryshe me ndonjë akt tjetër.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit Pushtetit Lokal dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform dispozitave të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisje lokale, Ligjit nr.08/L-284 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, si dhe Rregullores (QRK) nr.03/2026 për procedurën e shqyrtimit administrativ të akteve të komunave.

Nr.Prot. 01-020/p4-0044925/26
Podujevë, datë; 30 korrik 2026

